

GIDIOLA HYSA

**BASHKIMET SINTAGMATIKE NË FRAZËN POPULLORE
TË GJUHËS SHQIPE
(Fjalët e urta të Dibrës dhe Kukësit)**

Fjalja shihet në rrafshet të ndryshme, një nga rrafshet që analizohet është nga pikëpamja e strukturës së përbërësve të saj. Fjalitë nuk shihen si sekuenca të thjeshta fjalësh, por përbëhen nga sintagma të cilat nga ana e tyre mund të formohen nga sintagma të tjera, deri te fjalët më vete.¹

Për ndërtimin e frazës shërbejnë disa rregulla të përcaktuara qartë nga çdo gjuhë. Nga bashkimi i fjalëve lindin njësi sintaksore, ndër to përbërësi, që është një njësi ndërmjet fjalës e frazës, p.sh. *në mal, festoj ditëlindjen, mësuesja në klasë, e drejtë*, etj. janë përbërës sintaksorë.

Për dallimin e përbërësve në fjali ka disa rregulla, ku po i përmendim. Frazja e copëtuar, mospërfshirja, izolimi, zëvendësimi, bashkërenditja, elipsa, përbërësi dhe dykuptimësi².

Frazja nuk është një bashkim i çfarëdoshëm i fjalëve, por një organizim përbërësish. Vetë fraza është një përbërës i rendit më të lartë që përmban brenda vetes përbërës të tjerë.

Për studimin e strukturës së përbërësve ka një teori universale, Teoria X-bar e zbatohet në gjithë gjuhët e botës. Çdo përbërës ka një kokë, që është elementi qendror i përbërësit e cila i jep emrin, p.sh., nëse koka e një përbërësi është një folje, ai do të emërtohet sintagmë foljore ose **VP**, nëse koka është një emër kemi sintagmë emërore **NP**, nëse koka është mbiemër kemi sintagmë mbiemërore **AP** dhe nëse koka është një parafjalë kemi sintagmë **PP**.³


Ne thamë se koka është elementi qendror i një sintagme dhe i domosdoshëm për projektimin e saj. Një sintagmë përveç kokës ka dhe një komplement (compl.). Koka dhe komplementi përbëjnë nivelin më të lartë të përbërësit dhe paraprihen nga një specifikues (spec.). Koka, komplementi dhe specifikuesi dalin gjithmonë në të njëjtin pozicion. Projektimi i një sintagme bëhet gjithmonë nga poshtë – lart, koka përfaqëson nivelin bazë të projektimit, që shënohet me x^0 , që mund të zëvendësohet me një emër, folje, mbiemër, parafjalë. Njësia e formuar nga koka dhe komplementi shënohet me x' , njësia e formuar nga x' dhe specifikuesi shënohet me x'' . Teoria X-bar, është në gjendje të mbulojë pjesën më të madhe të lidhjeve të fjalëve. Sipas të dhënave të mbledhura nga studimet tipologjike, gjuhët e ndryshme të botës shfrytëzojnë një nga modelet të studiuara nga Greenberg-u (1966). Gjuhët si shqipja, anglishtja, italishtja, që kanë kundrinë pasfoljore, ku komplementi i emrit ndjek emrin, janë gjuhë që zgjedhin parametrin “koka

¹ T. Topalli, *Sintaksa e fjalisë*, Shkodër, 2013, f. 419.

² F. Koleci, G. Turano, *Hyrje në sintaksën gjenerativiste të shqipes*. Tiranë, 2011, f. 19.

³ G. Graffi, *Sintaksa. Strukturat e ligjëritimit*, Dituria, 2003, f. 111.

paraprin komplementin”, ndërsa gjuhë, ku kundrinori ka pozicion parafoljor, japonishtja dhe koreanishtja janë gjuhë që ndjekin parametrin” koka ndjek komplementin”.



Në këtë punim do të mundohem të paraqes analiza se si realizohen marrëdhëniet e fjalëve me njëra – tjetrën, te fjalët e urta të popullit të Dibrës dhe të Kukësit, këto të vjelura te “Fjalë të urta të popullit shqiptar, botim i Akademisë së Shkencave, Institutit të Kulturës Popullore. Për të realizuar këtë kam përdorur teorinë universale X-bar.

Gjatë parjes së këtyre fjalëve të urta, shfaqen sintagma emërore, NP; sintagma foljore, VP; sintagma mbiemërore AP; sintagma parafjalore PP. Japim shembuj:

- **Sintagma emërore NP**

Langu në shpi, peshku në dri, dhampiri, paqllëku, barku, sopata, dora, venin tan, Kulaçi i vendit të largjët, venin e huj, kali i huj, fjala e dhanme, puna e bame, gjaja e falme, ylli, mishi, puna e trimave, pounën e vogël, menia e dame, puna e bame, puna para, llafi mrapa, puna vrajk, vllai i detit, bukë për miq, plumb për armiq, hasmi i vjetër, mek i ri, miku mik, gjiza me pare, shoku i mëjërë, mëjk i dashtun, buka e huj, guri prej dore, galen e katunit, bukën tande, shtëpie e vogël, zemra e gjonë, shoku i mëjërë, mëjk i dashtun, buka e huj, Dekja me façe të bardhë, gjaja e vjedhme.

- **Sintagma foljore VP**

Gjumi ka fukarallojk, dora të fliç, shkoq një pashë⁴, rrokulliset lehte. turki asht dy ftyrësh qëndro. hupe sedrin, ke hup jetën, ka rroush, ruen vathë, ruen dele, ha gjathë, derdh djersë, ai gëzoet, luj kamët, mishi krymbave, puna e trimave, shajfëm të vramen, qaj sot, *asht mirë*, ban një pëllambë, shkoq një pashë, foli dada, lien derën, mbytem në Dri, rrugën lene, je i fortë, meku don tre sahana, ne qajmë një thes, këta qajnë një torbë, je me shokë, je i fortë, ban ner, xhij vner, asht haram.

- **Sintagma mbiemërore API**

i meçëm për gjysë⁵, guri i luejtun, punëkeq, fjalëmirë, e trimave, e vogël të madhe, e dame, e bame, punëkëq, fjalëmirë, i vjetër, i ri, i vetmi, i mbetmi, i fortë, i mëjërë, i dashtun, e huj, e amël, e vogël, e gjonë. e fortë, të bardhë, e vjedhme.

- **Sintagma parafjalore PP**

Për shnjergj, nga vllai, me viça, nga vendi i vet, në një vend ketër, në kuven, në derven, në fun të xhepit, në shpëj, në grykë, për miq, për armiq, pa patërrë, me krepjë, me mjaltë, me shamatë, me pare, për shoqni, në Dri, prej shoqit, me shokë,

⁴ Dora të turpëron, **po grabite**; prish një pash, ban një pëllambë e prish një pashë.





⁵ I mençur për gjysmë, **Ma mirë një budalla se sa I meçëm për gjysë**.

Bashkimet sintagmatike në frazën popullore të gjuhës shqipe

prej dore, në kufenin tan, për vete, në majë të kresë, në fund të themrës, me façe të bardhë, në një grazhd, në vorr, për horr.


Paraqitja strukturore e disa prej sintagmave.

Gjumi ka fukarallojk. Kjo është një sintagmë foljore VP, struktura e saj me skemën X-bar do të ishte:





Në strukturat e këtyre sintagma të mësipërme shikojmë se ndonjëherë nuk kemi specifikues apo në një rast tjetër mungon komplementuesi. Kjo ka të bëjë me nevojën që ka folja për t'u plotësuar kuptimisht dhe strukturalisht me anë të fjalëve apo përbërësve, që kërkojnë pranë vetes. Kjo dukuri tregon sa valentëshe është folja. Foljet i kemi, zerovalentëshe, njëvalentëshe dyvalentëshe, trivalentëshe. Fjalët apo përbërësit që kërkohen nga folja, në varësi të valencës së saj quhen argumente.

Një sintagmë emërore do kishte këtë strukturë: *peshku në dri*



Si komplement i sintagmës emërore me kokë peshku do të shërbejë një sintagmë parafrjalore që do ta paraqesin më poshtë.

Hasmi i vjetër




Në këtë rast, si komplement shërben një sintagmë mbiemërore, e cila duhet të analizohet më vete. Shenja e trekëndëshit tregon se këtë sintagmë mund ta analizosh përsëri

Paqllëku, kjo sintagmë përbëhet vetëm nga koka. Me këtë strukturë paraqiten emrat e përveçëm ose përemrat vetorë. Në rastin tonë *paqllëku* është veçuar te fjala e urtë, 11410. *Paqllëku e mba njeriun* e ka të njëjtën strukturë me emrat e përveçëm ose përemrat vetorë.


- Paraqitja strukturore e sintagmave mbiemërore është e varur nga struktura e mbiemrave.

Mbiemrat e nyjshëm paraqesin një strukturë ndryshe nga mbiemrat e panyjshëm. Këta kërkojnë një pozicion të veçantë për nyjën në brendësi të sintagmës mbiemërore. Hipoteza më e pranueshme është që nyja të gjenerohet Brenda në një pozicion D⁰, kështu do nevojitet një sintagmë mbiemërore, DPADJ (Adjectival DP)



Ndërsa po të ishte mbiemër i panyjshëm do të kishte një skemë standarde.

Sintagmat parafrjalore PP do kenë këtë paraqitje strukturore: për gjysë.



Të njëjtën strukturë do kishin dhe sintagmat: *për shnjergj, nga vllai, nga vllai, me viça, etj.*


- Nga projektimi i sintagmave të thjeshta, siç e pamë më lart le të mundohemi në projektimin e një fraze të tërë. Te projektimi në frazë, vështirësia

Bashkimet sintagmatike në frazën popullore të gjuhës shqipe


qëndron në projektionin maksimal. Kështu, nga rëndësia që ka fleksioni në frazë është arritur në përfundim se ai është shprehja më e lartë në frazë. Le të shikojmë më poshtë projektimin e sintagmave fleksionale.

Kështu kemi sintagma fleksionale (inflection phrase) IP: 2281. *Barku ash vllai i detit*, 2838. *Ka xhet peni gëzofin*.

Le të paraqesim skemën e kësaj sintagme: ***Barku asht vllai i detit***. Kjo është një sintagmë që përfshin brenda vetes dhe sintagma të tjera.




Në këtë skemë si kokë shërben I^0 *asht* dhe fleksioni shprehet me foljen është e cila në vetën e tretë njëjës të kohës së tashme mënyra dëftore, ndryshon rrënjë, pra nga jam bëhet *është*, por duke qenë se kemi të bëjmë me të folme dialektore në këtë rast kemi të shprehur foljen, *është* me një formë tjetër, që është dialektore *asht*. Folja asht gjenerohet në kokën e sintagmës fleksionale për t'u përshtatur me në numër dhe vetë me emrin *barku*. Kryefjala barku del si specifikues, por fillimisht del si specifikues i sintagmës VP. Ajo zhvendoset në këtë pozicion si rezultat i zhvendosjes sintaksore. Si argument i foljes shërben sintagma vllai i detit, e cila do të analizohet më vete dhe është një sintagmë DP. Skema e saj do jetë:



Sintagma, *vllai i detit* do të paraqitet nën këtë mënyrë, siç po e shikojmë dhe për gjithë emrat në rasën gjinore, që kanë nyje na sugjerohet **Dop (operator)**, ku projektohet nyja.


- Gjuhët si shqipja dhe italishtja mund të mos e kenë të shprehur kryefjalën si te fjala e urtë; 1759. *Ban një pëllambë e shkoq një pashë*. Kështu pozicioni i specifikuesit mbetet bosh, por sugjerohet pro e vogël, kur ajo nënkuptohet. Sintagma ban një pëllambë do realizohet me këtë strukturë. Siç po e shikojmë kjo

është një fjalë e urtë ku bashkërenditen sintagmat, e për ta realizuar të gjithë paraqitjen strukturore të kësaj fjale të urtë do nevojitet një pozicion dhe për lidhëzën bashkërenditëse e cila do zë vendin e kokës në frazë.




- Le të shikojmë sintagma të tjera që kanë specifikat e veta.

Paraqitja e sintagmës, *peri ka gjet gëzofin*. Kjo fjalë e urtë nga goja e dibranëve shprehet ndryshe, ka xhet peni gëzofin. Kjo fjalë e urtë, përveç vlerave kulturore paraqet dhe vlera të dialektit të Dibrës, gjithashtu dhe artistike, ku kryefjala nuk ka rendin normal që paraqet ajo, zakonisht përpara foljes. Për arsye stilistike është përmbysur ky rend.




Le të shikojmë fjalën e urtë: 2009. *Menia e dame, puna e bame*. Këtu na duhet një kategori funksionale ndërmjet DP sintagmës determinante dhe sintagmës emërore. Për këtë sugjerohet një kategori e përshtatjes AGREement Phrase shkurt AGRP. Kjo do të shërbente për të kontrolluar tipare, si ato gjinisë dhe të numrit. Nëse kjo është e pranishme në strukturë DP, atëherë emri e lë pozicionin e tij origjinal për t'u zhvendosur drejt pozicionit të kategorisë funksionale të përshtatjes në mënyrë që të bashkohet me tiparet e gjinisë dhe të numrit. Në rastin tonë emri ngrihet në pozicionin D⁰ të DP-së për t'u trupëzuar me nyjen.

Bashkimet sintagmatike në frazën popullore të gjuhës shqipe




të njëjtën strukturë ka dhe *puna e bame*.

- Te fjala e urtë dy gomarë në një grazhd, njeni bar –tjetri kashtë. Te sintagma dy gomarë lind e nevojshme të shpjegojmë dhe klasë tjetër. Kjo klasë është ajo e kuantifikorëve. Disa nga elementët që bëjnë pjesë në këtë klasë janë përemrat e pacaktuar si ca, disa, çdo, shumë, pak, numërorë të ndryshëm që dallohen nga përcaktorët e tjerë, sepse nuk përshtaten me emrat që shoqërojnë.



- Në kuadrin e gramatikës gjenerativiste, një ndër çështjet kryesore lidhur me studimin e klitikëve ka qenë përcaktimi i vendit të tyre. Kjo dukuri shfaqet shume në fjalët e urta të Dibrës. Klitizmi ose rimarrja e kundrinës, nuk shpjegohet veçse me rregullën e lëvizjes *move*. Për këtë ka sugjerime të ndryshme. Sipas Sportiche-I (1992), propozon një model, sipas të cilit klitikët janë koka flektive që projektojnë një sintagmë klitike CIP (clitik phrase), sipas tij projeksioni maksimal CIP qëndron midis pozicionit CP dhe IP. Pra sipas tij të gjithë klitikët gjenerohen në atë pozicion në të cilin dalin në sintaksën e shfaqur. Sipas kësaj teze, sintagma *dhampiri e njej lugjatin*, do të kishte këtë skemë.



Punimi nuk përfshin të gjitha veçoritë që shfaq shqipja në frazat e saj të mbuluara me skemën X-bar. Në punimet e mëtejshme mendoj të paraqes specifika të tjera të marrëdhënieve që krijojnë fjalët në një fjali apo deri në fjali. Kjo është një mënyre e re, universale që shikohen gjuhët deri në detaje. Mendoj, pse jo, dhe gjuha shqipe me larminë e saj të të shprehurit të mos analizohet me këtë lloj strukture.